



REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Pritjeten/Prodato Received/Delivery	21.08.2023	3 viti god year	
Organ /Njësia Org./Jedinica Org./Unit	Nr. Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMSHICK	5762/2023		1/6



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.888/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtare, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.888/2023 të datës 29.06.2023 të parashtruar nga ankuesja [redacted] me adresë: [redacted] kundër Agjencisë Kosovare të Privatizimit, në çështjen juridike "Kërkesë nga marrëdhënia e Punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2p të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 21.08.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.888/2023 e datës 29.06.2023 e parashtruar nga ankuesja [redacted]**
- II. Anullohet Vendimi me shifër DM 201/2023 i datës 31.05.2023 i Drejtorit të Burimeve Njerëzore të AKP-së dhe Akti i Emërimit me referencë:02/DM 7 i datës 05.06.2023.**
- III. Detyrohet Drejtori i Burimeve Njerëzore të AKP-së që ta emërojë ankuesen në pozitën "Udhëheqës i Komisionit të Listave" si dhe t'ia bëjë kompensimin e diferencës në pagë ndërmjet pagës për pozitën "Zyrtar i Lartë për Raportime" dhe pozitës "Udhëheqës i Komisionit të Listave" në mënyrë retroaktive dhe atë që nga data 01.06.2023.**
- IV. Obligohet Drejtori Menaxhues i Agjencisë Kosovare të Privatizimit që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi si në pikën III të dispozitivit.**
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.**

A r s y e t i m

Ankuesja, sipas shkresave të lëndës e punësuar në Agjencinë Kosovare të Privatizimit (*tani e tutje AKP*), me datë 29.06.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me shifër DM 201/2023 të datës 31.05.2023 të Drejtorit të Burimeve Njerëzore të AKP-së dhe Aktit të Emërimit me Referencë:02/DM 7 të datës 05.06.2023.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshilli, pretendon se Drejtoresha e Burimeve Njerëzore në AKP me rastin e mos emërimit të saj në një nga pozitat e nivelit drejtues në kuadër të AKP, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e ligjit material, respektivisht nenit 42 paragrafi 7 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, me kërkesën që Këshilli të anulojë aktet e kontestuara dhe të obligojë Drejtorin e Burimeve Njerëzore të AKP-së që ta emërojë ankuesen në një pozitë të kategorisë të nivelit drejtues si dhe t'ia kompensojë pagën ankuses nga datat 01.06.2023 deri në emërimin në një pozitë të kategorisë drejtuese.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës me datë 06.07.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuses në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, ndërsa kjo e fundit me datë 11.07.2023 ka përcjellë dokumentacionin e kërkuar me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 4949/2023 të datës 29.06.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendim me numër ref. BD-75/1 i datës 19.05.2016; Vendim me nr.ref.BD-117/4 i datës 25.04.2019; Vendim me numër DM 201/2023 i datës 31.05.2023; Akt emërim me numër të referencës 02/DM7 i datës 20.06.2023; Vendim me nr.ref.BD-181/7 i datës 29.05.2023; Vendim me nr.ref.BD-173/3 i datës 30.11.2022; Vendim me numër DM 213/2023 i datës 06.06.2023; Përshkrimi i punës për pozitën Kryesues i Komisionit të listave të 20% i datës 31.10.2017; Vendim me numër DM 62/2023 i datës 22.02.202; Përshkrim i punës për pozitën Kryesues i njësisë për përgatitjen e kontratave të shitjes dhe kontratave me negociim direkt i datës 11.07.2017; Diplomë e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës me numër 2762 i datës 25.05.2011; Plotësim i ankesës i datës 07.07.2023; Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2022; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 06.07.2023; Përgjigja në ankesë e datës 11.07.2023; Vendim me nr. Ref. BD-174-2 i datës 23.12.2022; Vendim me nr.ref.BD-176/2 i datës 14.02.2023; Vendim me numër DM 181/2023 i datës 08.05.2023; Zbatim i rekomandimeve të Vendimit të KPMSHCK me numër A.nr.541/2023 i datës 22.05.2023; Vendim me numër DM196/2023 i datës 23.05.2023; Vendim me nr.ref.BD-181/7 i datës 29.05.2023; Përshkrim i punës për pozitën Udhëheqës i Divizionit të Opinioneve Ligjore i datës 06.02.2023; Vendim me numër DM 58/2023 i datës 22.02.2023; Përshkrim i punës për pozitën Udhëheqës i Divizionit të Listave të 20%-it të Punëtorëve i datës 06.02.2023; Vendim me numër DM 62/2023 i datës 22.02.2023; Përshkrim i punës për pozitën Udhëheqës i Divizionit të Kontratave të Shitjes i datës 06.02.2023; Organogrami i Strukturës Organizative datës 15.05.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar që ankesa e ankuses është *e bazuar, sepse*:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në bazë të shkresave të lëndës ka gjetur se ankuesja, Valbona Dibra sipas Vendimit të Bordit të Drejtorëve me shifër BD-75/1 të datës 19.05.2016 është emëruar "*Zëvendës Drejtor Menaxhues-Shitjes*" nga data 01.06.2016 me mandat tre (3) vjeçar, ndërsa

sipas Vendimit me shifër BD-117/4 të datës 25.04.2019 ankueses i është vazhduar mandati nga data 01.06.2019 me mandat katër (4) vjeçar, respektivisht deri me datë 31.05.2023.

Tutje, Bordi i Drejtove përmes Vendimit me shifër BD-174-2 të datës 23.12.2022 ka njoftuar ankuesen lidhur me mos vazhdimin e mandatit të saj pas datës 31.05.2023 ashtu që pas përfundimit të mandatit të saj, Drejtori i Burimeve Njerëzore të AKP-së përmes Vendimit me shifër DM 201/2023 të datës 31.05.2023 ka sistemuar ankuesen në pozitën "Zyrtar i Lartë për Raportime" në kuadër të Zyrës së Drejtorit Menaxhues të AKP-së, duke i lëshuar Akt Emërimin e përherëshëm me Referencë:02/DM 7 të datës 05.06.2023, të cilin ankuesja e ka nënshkruar (me koment).

Kolegji i Këshillit, nga administrimi i shkresave të lëndës ka konstatuar se Agjencia Kosovare e Privatizimit përmes vendimit të Bordit të Drejtorëve BD-173/3 i datës 30.11.2022 ka aprovuar strukturën e re organizative dhe Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Sistemimin e Vendeve të Punës në AKP, përmes së cilës janë shuar katër (4) departamente dhe është krijuar një (1) departament i ri, ndërsa përmes Vendimit me numër BD-181/7 të datës 29.05.2023 Bordi i Drejtorëve ka shtyrë afatin për hyrje në fuqi të skemës së re organizative deri me datë 01.10.2023, me arsyetimin se duhet të pritur mendimin këshillimor nga ministria përgjegjëse për administratë publike, në rastin konkret Ministria e Punëve të Brendshme.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankueses ka analizuar dispozitat e nenit 42 paragrafi 7, 8 dhe 9 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik Ku përcaktohet se: *"Me mbarimin e mandatit sipas paragrafit 4 apo 5 të këtij neni, për kandidatët e emëruar në kategorinë e nivelit drejtues nga Shërbimi Civil, Njësia e Pranimit detyrohet të emërojë nëpunësin të cilit i mbaron mandati në një pozitë të kategorisë së mesme drejtuese dhe pastaj në pozitë të kategorisë profesionale. 8. Deri në emërimin në një pozitë, sipas paragrafit 7 të këtij neni, nëpunësi vazhdon të gëzojë të drejtën e pagës për pozitën e nivelit të lartë drejtues për një periudhë 3 mujore. Refuzimi për t'u emëruar në pozitën e nivelit të mesëm drejtues ose profesional, të caktuar nga Njësia e pranimit, liron nëpunësin nga Shërbimi Civil. 9. Gjatë periudhës 3 mujore në pritje të emërimit, nëpunësi mund të konkurrojë për çdo pozitë të kategorisë së lartë drejtuese, përveç asaj për të cilën i ka mbaruar mandati"* dhe nenit 15 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) nr. 01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues e ku përcaktohet se: *"1. Pas përfundimit të mandatit të nëpunësit të nivelit të lartë drejtues nga shërbimi civil, Departamenti për menaxhimin e zyrtarëve publikë për institucionet e administratës shtetërore dhe NJBNJ për institucionet tjera shtetërore është e obliguar që brenda afatit më të shkurtër kohor, të emërojë nëpunësin në një pozitë të kategorisë së mesme drejtuese nëse ka të lirë një pozitë të tillë, e nëse nuk ka të lirë atëherë e emëron në një pozitë të nivelit profesional"*, ndërsa ka gjetur se institucioni punëdhënës sipas arsyetimit të dhënë në Vendimit me shifër DM 201/2023 të datës 31.05.2023 për shkak të mungesës së pozitave të lira të nivelit të Mesëm Drejtues e ka sistemuar ankuesen në pozitën "Zyrtar i Lartë për Raportime" në kuadër të Zyrës së Drejtorit Menaxhues të AKP-së, kurse lidhur me pozitën drejtuese e cila ka qenë e lirë "Udhëheqës i Komisionit të Listave", sipas përgjigjes së dhënë për Këshill me datë 11.07.2023 nga Agjencia Kosovare e Privatizimit theksohet fakti se ankuesja nuk e përmbush kriterin e kualifikimit profesional.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankueses se Agjencia Kosovare e Privatizimit në momentin e përfundimit të mandatit të ankueses të njëjtës nuk i ka ofruar pozitë të nivelit drejtues të cilat kanë qenë të lira si ajo e "Udhëheqësit të Komisionit të Listave" në kuadër të Departamentit të Aseteve dhe Shpërndarjeve dhe pozita e "Kryesuesit të Njesisë për Përgatitjen e Kontratave të Shitjes dhe Kontratave me Negocim Direkt"

Kontabilitet, Juridik, Menaxhment, Biznes apo ndonjë fushë tjetër relevante", sikurse është konstatuar fakti se kjo pozitë ka qenë e lire me rastin e përfundimit të mandatit të ankueses.

Prandaj, nga se u tha si më lartë dhe pas analizimit të shkresave të lëndës, analizimit të dispozitave ligjore në fuqi, shqyrtimit të akteve të kontestuara përmes kësaj ankese dhe akteve të tjera që kanë lidhshmëri juridike me këtë rast, dhe konstatimeve të dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi, Kolegji i Këshillit vendos që ankesa e ankueses të aprovohet si e bazuar, ashtu që Drejtoria e Burimeve Njerëzore të AKP-së obligohet që ankuesen ta emërojë në pozitën *"Udhëheqës i Komisionit të Listave"* sikurse është potencuar edhe në arsyetimin e këtij vendimi, pasi që e njëjta i përmbush kriteret e përgatitjes profesionale sipas përshkrimit të detyrave të punës të cilat janë realisht në fuqi, ngase struktura e re organizative nuk mund të krijoj efekte juridike përpara datës së hyrjes në fuqi, konkretisht datës 01.10.2023.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit sjellë në vëmendje se Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe veçanërisht Komisioni i Ristrukturimit, vendimmarrjen e aplikuar e ka mbështetur apo e ka lidhur në atë mënyrë që vendimet për transferimin e nëpunësve të cilëve u janë shuar vendet e punës dhe i janë nënshtruar procesit të ristrukturimit e ka ndërlidhur me rastin e hyrjes në fuqi të strukturës së re organizative, respektivisht për aktet e nxjerra në faza të mëhershme, momentin e krijimit të efekteve juridike apo të hyrjes në fuqi e ka ndërlidhur në mënyrë specifike me hyrjen në fuqi edhe të skemës së re organizative, mirëpo deri në atë moment të njëjtit do të mbajnë apo ushtrojnë pozitat e punës sipas përshkrimit të vjetër të detyrave të punës për pozitat përkatëse, prandaj në rrethanat e rastit aktual ankuesja fillimisht është dashur t'i nënshtrohet procesit të sistemimit apo emërimit për pozitën e cila ka qenë e lirë sikurse është theksuar në arsyetimin e këtij vendimi, ndërsa pasi që e njëjta të emërohet në pozitën *"Udhëheqës i Komisionit të Listave"* mund t'i nënshtrohet procesit të transferimit për shkak të ristrukturimit nën kushtet dhe rrethanat e barabarta sikurse është vepruar edhe me zyrtarët e tjerë më rastin e ristrukturimit.

Lidhur me kërkesën e ankueses për kompensim e pagës deri në emërimin e së njëjtës në pozitë tjetër drejtues duke u bazuar në nenin 42 paragrafi 7 dhe 8 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *"7. Me mbarimin e mandatit sipas paragrafit 4 apo 5 të këtij neni, për kandidatët e emëruar në kategorinë e nivelit drejtues nga Shërbimi Civil, Njësia e Pranimit detyrohet të emërojë nëpunësin të cilit i mbaron mandati në një pozitë të kategorisë së mesme drejtuese dhe pastaj në pozitë të kategorisë profesionale; 8. Deri në emërimin në një pozitë, sipas paragrafit 7 të këtij neni, nëpunësi vazhdon të gëzojë të drejtën e pagës për pozitën e nivelit të lartë drejtues për një periudhë 3 mujore. Refuzimi për t'u emëruar në pozitën e nivelit të mesëm drejtues ose profesional, të caktuar nga Njësia e pranimit, liron nëpunësin nga Shërbimi Civil"* Kolegji i Këshillit vlerëson se është e bazuar për shkak të arsyetimit të dhënë si më lartë, ngase është gjetur se sistemimi i ankueses në pozitë profesionale duke e anashkaluar pozitën e nivelit drejtuese është bërë në kundërshtim me dispozitat e aplikuara të ligjit material, prandaj në rrethanat e rastit konkret Drejtori i Burimeve Njerëzore të AKP-së është e obliguar që me rastin e sistemimit të ankueses sikurse është përcaktuar në dispozitivin e këtij vendimi, t'ia bëjë edhe kompensimin e diferencës në pagë ndërmjet pagës për pozitën *"Zyrtar i Lartë për Raportime"* dhe pozitës *"Udhëheqës i Komisionit të Listave"* në mënyrë retroaktive dhe atë që nga data 01.06.2023 deri në ditën e zbatimit të këtij vendimi.

Prandaj, nga se u tha si më lartë, ndërlidhur me të gjeturat e përcaktuara si më sipër në arsyetimin e këtij vendimi, Kolegji i Këshillit, ka konstatuar se Drejtori i Departamentit të Burimeve të AKP-së, nuk ka vepruar drejtë dhe në mbështetje të dispozitave ligjore me rastin e sistemimit të ankueses në

pozitën e nivelit profesional në kuadër të shërbimit civil siç përcaktohet me nenin 42 paragrafi 7 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, ashtu që Këshilli ka aprovuar ankesën e ankueses lidhur me sistemimin e saj si të bazuar edhe sa i përket kompensimit të pagës, ndërsa mbështetur në nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 dhe 1.5 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: "Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.4. është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material" pasi që aktet e goditura përmes kësaj ankese, respektivisht Vendimit me shifër DM 201/2023 i datës 31.05.2023 dhe Akt Emërimi me Referencë:02/DM 7 të datës 05.06.2023 janë të paligjshme për shkak se të njëjtat janë nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e ligjit material sikurse është përcaktuar në arsyetimin e këtij vendimi, sikurse arsyetimi i dhënë lidhur me nxjerrjen e këtyre akteve është i mangët, jo i plotë apo i barabartë me mungesën e tij, ngase sikurse përcaktohet edhe me nenin 48 paragrafi 1, nën paragrafi 1.4 i të njëjtit ligj, ngase akti i kontestuar askund nuk përmban arsyetim të qartë lidhur me bazën ligjore të vendimit dhe arsyeën pse janë të zbatueshme këto dispozita në rastin konkret, prandaj të njëjtat janë anuluar sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.888/2023

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Drejtorit Menaxhues të Agjencisë Kosovare të Privatizimit;
- Drejtorit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit;
- Arkivit të KPMSHCK-së

